

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
LA CASA DEL SORRISO SHPK**

Ne Tirane, sot me date 01.06.2021

Z.Emilian Bali shtetas shqiptar, i biri i Hysen lindur me 27.04.1988 Durres ,dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet Nr.Pashaporte BE4349746 dhe nr. personal I80427084V.

I cili harton kete Akt Themelimi te shoqerise **LA CASA DEL SORRISO SHPK** mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit ", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **LA CASA DEL SORRISO SHPK**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **LA CASA DEL SORRISO SHPK**, eshte nje shoqeri, që themelohet ndërmjet ortakut që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, ne Rrugen "Ibrahim Rugova " Zona kadastrale 8270 me nr pasurie 3/280+1-25 Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:

Veprimtari ne fushen Sherbimit dhe tregtise ne fushen Dentare. Si dhe çdo aktivitet tjetër i konsideruar fitimprures dhe ne interes te shoqerise ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise, dhe qe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin Shqiptar.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise **LA CASA DEL SORRISO SHPK** eshte e pakufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 lekë (njeqind leke).

- a) Ortaku **Emilian Bali** eshte zoterues i 1(nje) pjese me vlere nominale 100 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Mënyra te fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi tëkufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

1. a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdomënyretjetërtëparashikuarmeligj.

1. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
2. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e hoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.



3. Nërastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8 **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakut është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakut është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin në çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 9
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator **Z. Emilian Bali** sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5-vjecare me te drejte ripertesitje.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratoret ne çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund te emerohet edhe nje person jashte ortakërisë.

Neni 10
Kompetencat

Administratorët kane të drejtë e detyrohen të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e pergjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së pergjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyrat e tjera të përcaktuara në ligjin dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.



Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaku i shoqerise tregtare **LA CASA DEL SORRISO SHPK**

nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKU THEMELUES TE SHOQERISE LA CASA DEL SORRISO SHPK

EMILIAN BALI

Emilian Bali
